

KONTRATË SHITBLERJE KUOTA KAPITALI

Lidhur sot me 29.05.2020

ndermjet:

Z. FATMIR BILALI (më poshtë do të përmendet si "Shitësi") lindur më 12.03.1974 në Dinslaken Gjermani, identifikuar me pasaportë gjermane nr. C6W9FHCTV, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar

dhe

Znj. STELA PAJTIM BILALI (më poshtë do të përmendet si "Blerësi"), shtetase shqiptare, lindur më 13.12.1975 në Tiranë, Shqipëri, identifikuar me ID me nr. personal H56213038T, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar

Shitësi dhe Blerësi do të referohen më poshtë edhe si "Palët".

MEQËNËSE

- Shitësi, zotëron 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "Softvision sh.p.k.", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, NUIS L81409025R, me seli ne Tiranë Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovareve, Nd. 6/230, Kati 1, 1001, me kapital të regjistruar prej 60.000,00 (Gjashtëdhjetë mijë) lekë;

- Blerësi kërkon të blejë 50 % (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë "Softvision sh.p.k.";

- Në bazë të vendimit të Asamblesë së Ortakut të Vetëm të Shoqërisë "Softvision" sh.p.k të datës 29.05.2020 është marrë vendimi për transferimin nëpërmjet shitblerjes së kuotave të zotëruara nga Shitësi në Shoqërinë "Softvision" sh.p.k në masën 50% (Pesëdhjetë përqind) dhe blerjen e tyre nga Blerësi.

ATËHERË

Palët kanë lidhur marrëveshjen me kushtet e mëposhtme:

NENI 1

OBJEKTI I MARRËVESHJES

Shitësi shet, dhe Blerësi blen 50% (Pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Softvision" sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, NUIS L81409025R, me seli ne Tirane Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovareve, Nd. 6/230, Kati 1, 1001, me kapital te regjistruar prej 60.00,00 (Gjashtëdhjetë mijë) lekë.

NENI 2

VLERA E MARRËVESHJES

2.1. Çmimi i shitjes për 50% (Pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Softvision" shpk është 30.000,00 lekë (tridhjetë mijë) Lekë.

2.2. Palët deklarojnë se pagesa e plotë e shitjes është marrë nga shitësi në datën e nënshkrimit të kontratës.

NENI 3

EFEKTET E MARRËVESHJES

Duke filluar nga data e kësaj marrëveshje Shitesi do të zotërojë 50% (pesëdhjetë përqind) kapital të shoqërisë "Softvision" shpk ndërsa Blerësi bëhet kështu ortak i kuotave të mbetura, që përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë "Softvision" shpk.

NENI 4

TË NDRYSHME

4.1. Shitesi deklaron se nuk ka asnjë kufizim mbi të drejtat mbi kapitalin e shoqërisë Softvision sh.p.k. dhe se ato janë të lira kundrejt çdo lloj kufizimi, barre apo detyrimi.

4.2. Në rast mosmarrëveshje të palëve mbi kushtet, detyrimet dhe interpretimin e kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për ti zgjidhur me mirëkuptim. Në rast të kundërt Gjykata e Tiranës do të jetë kompetente për zgjidhjen e këtyre mosmarrëveshjeve.


4.3. Kjo marrëveshje është përgatitur në 4 (katër) kopje që kanë të njëjtën vlerë juridike.

4.4. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me firmosjen nga palët.

Palët firmosin këtë marrëveshje në datën e përcaktuar më lart.

Shitesi

FATMIR BILALI



Blerësi

STELA BILALI

